

STATUTI

I SHOQERISE TREGTARE " T.T.Soil & Earthquake Consulting " Sh.p.k. TIRANE

Neni 1

Duke marre ne konsiderate se shoqeria "T.T.Soil & Earthquake Consulting " sh.p.k. eshte themeluar me date 03.03.1994 dhe eshte rregjistruar ne gjykate me vendim nr.2256 date 03/03/1994 si person juridik shqiptar, e cila funksionon ne formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

Ne baze te ligjit nr 9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare " i cili ne Nenin 230 te tij detyron te gjitha shoqerite tregtare qe kane ekzistuar perpara hyrjes ne fuqi (perpara dates 21 Maj 2008), te pershtasin organizimin dhe funksionimin e tyre sipas dispozitave te ligjit ne fjale brenda nje afati tre vjecare pas hyrjes ne fuqi te (afat deri me 21.05.2011).

Atehere: Asambleja e pergjithshme e shoqerise ka miratuar kete Statut te pershtatur e te perditsuar me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 , "Per tregtarete dhe shoqerite tregtare ", ne vecanti me dispozitat e Nenit 68 e ne vazhdim te ketij ligji ku rregullohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar, kjo ne perputhje me ligjin shqiptar dhe cdo legjislacion te mevonshem te zbatueshem.

Ne momentin e perditesimit te ketij statuti, ortaku i shoqerise "T.T. Soil & Earthquake Consulting" sh.p.k. eshte :

1. Z. Neritan Shkodrani, me shtetesi dhe kombesi shqiptare lindur me dt. 17/02/1965 ne Lushnje indetifikuar me karte identiteti me nr. Personal G50217039L, banues ne Tirane.

Neni 2

EMERTIMI DHE FORMA E SHOQERISE

Emertimi i shoqerise tregtare te themeluar nga ortaku i saj do te jete "T.T.Soil & Earthquake Consulting" sh.p.k. Tirane.

Forma e shoqerise tregtare te themeluar do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise do te jete:

Punime dheu murature, betoni, beton/arme te zakonshem, punime shembje ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore e kopletime me instalimet e nevojshme per to punime restaurimi, tregtim mjetesh e matriaresh ndertimi, artikuj industrial, lende te pare per industrite, tregtim karburantesh me pakice lende te pare per ndertim, matriale e pajisje hidrosanitare, turistike, bujqesore e kopletime me instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, tregtim mjetesh e matriaresh ndertimi, artikuj industrial, tregtim karburantesh me pakice lende te pare per ndertim, matriale e pajisje hidrosanitare, Germime dhe dhe punime eventuale murature e beton arme- prishje dhe punime ne toke te germuar. Prodhim maetriaresh ndertimi, prodhim materiale inerte gure, prodhim qeramike-tulla-tjegulla fajance, prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme e te paranderur, gure dekorative, prodhim materiale te lidhjes gelqere-allci-cimento, prodhim materiale me baze bitumi sintetike. Ne fushen e projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve. Punime civile dhe industriale: Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, deri ne 5 kate. Ndertime civile, industriale, turistike, sportive, bujqesore, mbi 5 kate dhe rikonstruksione. Ndertime me shkalle te larte veshtiresie, me skelet beton arme dhe metalike mbi 8 kate, guacka, sillosa, kulla etj. Punime rrugore dhe hekurudhore: Rruge kategoria V dhe IV, III, II dhe I, shtresa rruge, sistemime asfaltme. Vepra arti: Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 m dhe mbi 10 m. Puse - Shpime, Gjeologo- Inxhinierike-. Shpime per uje.

Neni 4

SELIA E SHOQËRISË

Shoqeria "T.T.Soil & Earthquake Consulting" Sh.p.k do ta kete seline saj ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr.7,rruga Myslym Shyri, godina me Nr.10 me Nr. pasurie 5/308+4, zone kadastrale me Nr.8250, ne katin e dyte, dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne gjithe teritorin e e Republikes se Shqiperise.

Ajo mund te krijojë ose të mbyllë në Shqiperi ose jashte saj, filiale, përfaqësi apo seli të tjera.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE



Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Si dite e fillimit te aktivitetit te saj do te merret data e rregjistrimit ne gjykate. Ortaku i shoqerise ka te drejte ta zgjase kete afat.

Neni 6

KAPITALI I THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i neshkruar i shoqerise eshte 100 000 (njqindmije) leke i cili perbehet nga kontributi vetem ne para. Ky kapital, i cili perbehet nga 1 pjese eshte nenshkruar nga ortaku i vetem dhe vlera nominale e nje pjese eshte 100000 leke. Kuotat ne kapital zoterohen nga z. Neritan Shkodrani, i cili zoteron 1 pjese ose 100%. Administratori i shoqerise do te jete z. Neritan Shkodrani .

Neni 7

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria ose te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo ti behen te ditura asaj .

Neni 8

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR ME TRASHGIMI OSE BRENDA FAMILJES

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge te trashegueshme. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

Neni 9

ADMINISTRIMI

Administratori i shoqerise tregtare "**T.T. Soil & Earthquake Consulting**" sh.p.k eshte z. Neritan Shkodrani. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve. Afati i administratorit te shoqerise do te jete 5 vjet.

Neni 10

PERGJEGJESIA LIGJORE E ADMINISTRATOREVE

Administratori eshte pergjegjes individualisht, sipas rastit ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Neni 11

SHKARKIMI I ADMINISTRATOREVE

Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqsojne me teper se gjysmen e pjeses te kapitalit themeltar. Çdo klauzole e kundert konsiderohet e pavleshme ne rast se shkarkimi eshte bere pa arsye te drejt, ai le shkak per demshperbilm fianciar. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te çdonjerit prej ortakeve.

Neni 12

MIRATIMI I LLOGARIVE TE SHOQERISE DHE E DREJTA PER INFORMIMIN E ORTAKEVE

Ne mbyllje te çdo viti financiar administratori bene inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe hartojne nje raport me shkrim per administrimin. Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratoret, i nenshtrohen miratimit te asamblese se ortakeve brenda nje afati prej gjashte muajsh duke filluar nga data e mbylljes se vitit fianciar. Dokumentat e permendura ne paragrafin e mesiper, teksti i vendimeve te propozuara, si dhe, ne qofte se eshte nevoja, raporti i ekspertit kontabel te autorizuar, u komunikohen ortakeve dhe vihen ne dipozicion te tyre ne seline e shoqerise te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese. Çdo vendim i marre, duke shkelur rregullat e ketij paragrafi konsiderohet i pavlefshem .



Neni 13

REZERVAT E DOMOSDOSHME

Shoqerite me pergjegjesi te kufizuar nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, lene menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 te tij, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme". Cdo vendim i kundert eshte i pavleshem. Kjo lenie menjane nuk eshte detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar .

Neni 14

FITIMI QE DO TE SHPERNDAHET

Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit ose statutit dhe nga ana tjeter, jane zbritur ose jane shtuar repsektivisht humbjet apo fitimiet e bartura nga vitet e meparshme .

Asambleja mund te marre vendim qe te shperndahen shumat e lena menjane per rezerven qe ajo ka ne dispozicion. Ne kete rast vendimi tregon shprehimisht llojet e rezerves ku jane marre keto shuma .

Neni 15

ORTAKET E SHOQERISE

Ortaket e shoqerise miratojne llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontable te autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja vitit financiar .

Ortaket mund ti delegojne kompetencat e tyre. Vendimet e tyre, te marra ne mbledhjen e asamblese, evidentohen ne nje rregjister.

Neni 16

PRISHJA E SHOQERISE

Shpalllet ne mbledhjen e asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise.

- Shoqeria priset automatikisht me mbarimin e afatit sipas statutit.
- Shoqeria mund te mbylle aktivitetin e saj perpara afatit te caktuar ne kontrate, kur ortaket vendosin me marreveshje per mbylljen.
- Aktiviteti rezulton me humbje per nje periudhe prej tre vitesh te njepasnjeshem.
- Kur kapitalet e veta behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar.

Ne rast te mbylles se aktivitetit, ne cdo kohe ose per cdo arsye, asambleja e ortakeve cakton menyren e likuidimit te saj dhe emeron nje ose me shume likuidatore. Ortaket thiren ne fund te procesit te likuidimit qe te vendosin per bilancin perfundimtar, per aktin e rregullshmerise nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likujdues, si dhe per te evidencuar mbylljen e likuidimit te saj.

Neni 17

DISPOZITA TË PERGJITSHME

Per gjithçka qe nuk eshte shprehur ne kete statut dhe ne aktin e themelimit te kesaj shoqerie do tu referohemi ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

Ky statut u shkrua, lexua dhe u firmos me vullnet te lire e ndergjegje te plote nga ortaket themelues te shoqerise " **T.T. Soil & Earthquake Consulting** " sh.p.k , Tirane sot me datën 23/08/2021, në kater kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I VETEM

I SHOQERISE "T.T. Soil & Earthquake Consulting " sh.p.k. TIRANE

Neritan Shkodrani

